

Data 17.02.2023

PROCESVERBAL

për mos-ndarjen në lote të procedurës së Hapur mbi kufirin e lartë monetar

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ““BLERJE KOSHA STOLA DEKORATIVE” - Marrëveshje Kuadër me nje Operator Ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 36 mujore nga nënshkrimi i Marreveshjes Kuadër

*Fondi limit: 52 660 000 (pesedhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH ose 457 276.8 (katerqind e pesedhjetë e shtatemije e dyqind e shtatedhjetë e gjashtë pike tete) Euro pa tvsh referuar kursit te kembimit te Bankes se Shqiperise date 23.02.2023 (**1euro =115.16 ALL**),*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kosha 39224340-3,Stola 39113600-3

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, autoriteti/enti kontraktor **DPPGJ** ka hartuar procesverbalin për për mos-ndarjen në lote të procedurës së Hapur mbi kufirin e lartë monetar, me arsyetimin si më poshtë:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë prokurimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik, pasi lloji i furnizimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm realizimin e qëllimit për të cilin prokurohet. Ndarja në lote do të sillte konfuzion pasi kemi të bëjmë me artikuj me ngjashmëri dhe procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte çrregullim në proces dhe vështirësi si dhe kosto shtesë për AK. Realizimi i njërit lot do të çonte në dështimin e procedurës.

Për këtë arsye, është e pamundur që të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, rrjedhimisht AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e e saj.

Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me furnzim dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Pra duke parë natyrën, specifikat dhe përmasën e kësaj kontrate, ndarja e procedurës në lote do të përbënte një kosto të shtuar për institucionin duke e bërë në këtë mënyrë pa mundur realizimin dhe monitorimin e këtij shërbimi në kostot që do ti shtoheshin institucionit tonë në rastin e ndarjes në lote.